

Pjelloria: Vëzhgimi i saktë i afsheve



Nga Elisabeth Stöger, veterinere në Austri

Faktorët ndikues: Shumica e fermave përqipen të përmirësojnë pjellorinë e lopëve. Kur ne flasim për pjellorinë, bëhet fjalë për shumë faktorë të ndryshëm. Në varësi të situatave të ndryshme do të ketë dhe rezultate të ndryshme.

Një pikë e rëndësishme në të kuptuarit e pjellorisë, është fakti që lopa është një gjitar. Tek të gjithë gjitarët, energjia e marrë nga ushqimi, përdoret në një radhë të caktuar për plotësimin e nevojave. Si fillim përdoret natyrshëm për mbijetesën dhe aktivitetet bazike të kafshëve dhe pastaj për gjendrat e qumështit. Kur të ushqyerit mjafton vetëm për të dhënë qumësht, atëherë cikli nuk është i mundur. Shprehja e vjetër, „Një lopë që humbet nuk shton në peshë“ vlen ende. Përpara se të fillojë cikli i ovulimit, janë të nevojshme rezervat (jo dhjamosje). Në përfundim mund të themi se deficieti i energjisë në të ushqyer është një shkaktar i zakonshëm për mungesën e riprodhimit.

Vëzhgimi i afshit: Shpesh problemi i pjellorisë nuk varet nga lopa por nga vëzhgimet e afsheve. Lopët vinë në afsh, por për shkak të mungesës së vëzhgimeve, ndërzimi nuk bëhet. Koha për punë në stallë është e pakët dhe e mangët, për pasojë shpesh mungon durimi dhe koha nga punonjësit për të vëzhguar me qetësi tufën për të konstatuar lopët në afsh. Kur në stallë nuk është i

pranishëm demi, atëherë duhet investuar kohë për vëzhgimet e afsheve në stall. Në tabelë gjenden fakte mbi lidhjen midis kohës së vëzhgimit të afshit dhe zbulimit të afsheve. Kushdo që investon vetëm 20 minuta dy herë në ditë, do të humbë konstatimin e afsheve të rreth një të tretës së lopëve. Është gjithashtu e dobishme dhe e nevojshme të bëhet në mesditë ose në mbrëmje një xhiro në stallë për të konstatuar shenjat e afsheve.

Efektiviteti në vëzhgimin e afshit (nga Kruif, Mansfeld, Hoedemaker)

Metodat	% e lopëve që janë identifikuar si në afsh
Vëzhgime në 24 orë	95 %
Vëzhgime	95 %
Tre herë në ditë, 20 minuta	75 %
Dy herë në ditë, 20 minuta	65 %
Një herë në ditë, 20 minuta	50 %

Shenjat e afshit: Shenjat tipike të fillimit të afsheve janë kafshë të lëvizsshme dhe rënkime, gjithashtu edhe kërkimi i kontaktit me kafshët e tjera. Kërcimi mbi lopët e tjera tregon që lopa është në afsh, por vjen edhe si shfryerje e stresit. Prandaj shenjat e sigurta të afshit janë si më poshtë:

1. Lopa në afsh qëndron, kur mbi të kërcen një lopë tjetër.
2. Lopa në afsh i hidhet një lope tjetër në kokë.
3. Prania e sekrecioneve të afshit me strukturë të ndryshuar dhe të qartë.

Kur nuk është e qartë nëse një lopë është në afsh, mund të jetë i nevojshëm vëzhgimi i vulvave. Ato janë gjatë afshit të enjtura, të zgjatura dhe nuk kanë rrudha. Ato janë lehtësisht të hapura dhe me një mukozë ngjyrë rozë në të kuqe. Lopët jo në afsh i kanë vulvat të shkurtra, të forta, të palosura, jo të ndara dhe me mukozë të zbehtë. Një tub dhe një dritë dore mund të jenë ndihmë e madhe për

zbulimin e afsheve. Inseminimi artificial duhet të bëhet në fund të afsheve kryesore.

Infeksionet e uterusit. Infeksioni i mukozës së uterusit quhet katarra gjenitale. Si rezultat do të ketë sekrecione të turbullta, të verdha ose të bardha dhe të përziera me qelb. Në rastet më të rënda sekrecionet janë në ngjyrë kafe dhe me erë të keqe.

Shkaqet e inflamacionit të uterusit janë:

- Abortet
- Lindjet e vështira ose në mënyrë të papërshtatshme
- Mungesa e higjenës
- Trajtimi jo i duhur i placentës pas lindjes
- Ushqyerje e gabuar
- Çrregullimet metabolike gjatë lindjes.

Për shkak të këtyre faktorëve krijohen infeksione të organeve gjenitale dhe uterusit. Shpesh herë sëmundja mbetet e pazbuluar deri në ndërzimin tjetër. Vetëm atëherë dallohet nga sekrecionet e papastra që inflamacioni është i pranishëm dhe ndërzimi nuk bëhet me sukses sepse vezët e plenuara nuk mund të vendosen në uterusin e infektuar. Nga infektimi i lopës me mikrobe të tjera mund të krijohet dhe të shfaqet sëmundja e mastitit të gjirit. Katarra gjenitale duhet të zbulohet dhe të trajtohet sa më shpejtë të jetë e mundur.

Sëmundjet e vezoreve: Në secilën prej vezoreve të kafshës së shëndetshme jo barëse zhvillohet cikli i ovulimit. Kjo konsiston në krijimin e një folikule dhe ovulimin në momentin e ndërzimit pastaj ndiqet nga formimi i trupit të verdhë si dhe nga riformimi i tij në pllenimin e munguar dhe nga formimi i ri i folikulës. Çdo fazë e këtij cikli mund të prishet për arsye të mëposhtme:

- Vezoret mund të jenë të pazhvilluara dhe pa asnjë funksion
- Ovulacioni mund të mos ndodhë dhe në vend të vezës formohet një cist
- Trupi i verdhë nuk riformohet dhe kështu pengohet fillimi i ciklit të ri

Për të dalluar midis çrregullimeve të ndryshme në vezore, lopa vizitohet dhe pas diagnostikimit fillohet me terapinë e përshtatshme, por çfarë nuk duhet të harojmë, është se të gjitha gjendjet e lopës ndikojnë në pjellori. Kjo do të thotë që mungesa e energjisë dhe formimi i kisteve nuk duhet të trajtohet me hormone, por një rregullim i ushqyerjes do të çojë në sukses. Për shkak se një folikule i duhet rreth 60 ditë për t'u maturuar, faza e mbarsjes është e një rëndësie të veçantë për pjellorinë e mëvonshme. Mund të supozohet se problemet e pjellorisë kanë të bëjnë në 80% të rasteve me problemet e mjedisit; gjë që menaxhohet duke marrë masat e duhura. Gabimet në ushqyerje: përveç mungesës së energjisë, që u përmend më sipër, shkak tjetër kryesor për pjellori të ulët gjithashtu edhe furnizimi i tepruar me proteina.

Fazat e mbarsjes	Kohëzgjatja	Shenjat
Fillimi i afsheve	deri në 3 ditë	Shqetësim, lëvizje, kërkojnë kontakt me kafshët e tjera kërcime dhe skuqje të organeve gjenitale
Afshet kryesore	8-30 Orë	Sekrecione, qëndrim kur kafshët e tjera
Fundi i afsheve	12-24 Orë	Kalimi i simptomave, gjakderdhje pas 1-3 ditësh

Shkaqe të tjera të sterilitetit: Dhjamosja dhe rritja e shpejtë, mungesa e lëvizjes dhe dritës, stresi dhe shqetësimi në tufë, kushtet e papërshtatshme, si: dysHEME rrëshqitshme, korridore dhe shtretër të ngushtë, probleme në ngritjen nga shtrati për shkak të stallës së ndërtuar gabim. Kushtet optimale të ambientit dhe mjedisit përreth ndikojnë në përmirësimin e pjellorisë dhe shëndetit të kafshëve.